

Progetto cofinanziato da



Istituto Nazionale
per lo studio e la cura
delle popolazioni migranti e per lo studio
della salute dei Paesi Terzi



National Institute for Health
Migration and Terzi



MINISTERO
DELL'INTERNO

Fondo Europeo per l'Integrazione dei Cittadini dei Paesi Terzi

LA SALUTE VIENE DA te

Informazione pre-partenza ai cittadini
dei Paesi Terzi sulle modalità d'accesso
al Servizio Sanitario Nazionale



SHËNDETI VJEN DREJT JUSH

**UDHËZUES PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR
KOMBËTAR PËR NENSHTETASIT**

të cilët nuk bëjnë pjesë në BE

TREGUES

Përmbledhje	2
Informacione të përgjithëshme	3
Regjistrimi i detyrueshëm në SSN	4
Regjistrimi vullnetar në SSN	6
Si bëhet regjistrimi	8
Përfshirja nga detyrimi i pagesës së ticket	9
Shërbimet e SSN	10
<i>Mjeku i Mjekësisë së Përgjithëshme ose Mjeku i Familjes dhe Pediatri i Zgjedhur</i>	10
<i>Shërbimi i vazhdueshëm (i pandërprerë) asistencial (ish roja mjekesore)</i>	10
<i>Konsulltorja familjare</i>	11
<i>Vaksinat</i>	12
<i>Ilaçet</i>	12
<i>Vizitat specialistike, analizat e laboratorit dhe ato instrumentale</i>	12
<i>Shtrimi në spital</i>	13
<i>Numri 118</i>	14
<i>Ndihma e Shpejtë</i>	14

PËRMBLEDHJE

SSN (Shërbimi Shëndetësor Kombëtar): është një rrjet kombëtar i shërbimeve shëndetësore, që ju ofrohet personave të regjistruar. Këto shërbime mundt të kryhen falas apo me pagesën e nje kontributi të pjeshëm që quhet ticket.

ASL (Ndërmarrja Shëndetësore Lokale): është një institucion që drejton shërbimet shëndetësore në nivel lokal. Drejtohuni pranë ASL të vendqëndrimit tuaj,apo të vendndodhjes aktuale (shënoni adresën që ndodhet mbi lejen e qëndrimit), për të marrë informacione mbi regjistrimin dhe shërbimet lokale.

Ticket: është një kontribut ekonomik që qytetarët paguajnë për disa shërbime shëndetësore publike; kjo pagesë i korrispondon vetëm një pjese të vlerës së plotë të shërbimit. Ticket paguhet duke paraqitur recetën e mjekut pranë sporteve të ambulancave, apo të spitalit ku kryhen vizitat mjekësore apo analizat.

INFORMACIONE TË PËRGJITHËSHME



Ligjet italiane njohin shëndetin si një të drejtë themelore për secilin person. Në fakt, edhe pse në forma të ndryshme, të gjithë personat që ndodhen në Itali kanë të drejtën e ndihmës dhe të mjekimit.

Është e rëndësishme të dini që, në qoftë se do të jetoni në Itali për një periudhë mbi tre muaj, duhet të pajiseni me një sigurim shëndetësor, i cili bëhet nëpërmjet regjistrimit në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (SSN).

Në bazë të arsyes së qëndrimit tuaj në Itali, regjistrimi në SSN mund të jetë **regjistrim i detyrueshëm** (falas) ose **regjistrim vullnetar** (ky i fundit si alternativë e një sigurimi privat, kundrejt pagesës së një shume vjetore).

Në qoftë se do të qëndroni në Itali për një **periudhë më të shkurtër se tre muaj** (vizë për turizëm, vizitë, biznes, etj.) apo **hyni në Itali për kurim mjekësor**, nuk është e mundur që të kryeni regjistrimi në SSN, as në mënyrën e detyrueshme, as në atë vullnetare. Në të tilla raste vetëm kundrejt pagesës të të gjithë shumës përkatëse të shërbimit, perfitoni të gjitha shërbimet mjekësore që ofron SSN.

Vini re! studentët dhe personat që jetojnë nëpër familje, pranë së cilave kryejnë disa punë shtëpiake në këmbim të fjetjes dhe ushqimit (lavoro alla pari), mund të kërkojnë regjistrimin vullnetar edhe pse qëndrojnë në Itali për një periudhë më të shkurtër se tre muaj.



Në qoftë se hyni për herë të parë në Itali, dhe kërkonti një leje qëndrimi që zgjat më shumë se një vit, duhet firmosur një akord integrimi me Shtetin. Ky akord i drejtuar nga Sporteli Unik per Emigracionin, zgjat dy vjet dhe funksionon me sistem kreditor.

Mbas regjistrimit në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar dhe zgjedhjes së mjekut të mjekësisë së përgjithëshem ose mjeku i familjes, përfitohet e drejta e fitimit të 4 krediteve.



Informacionet që përmban kjo broshurë janë në përgjithësi, të vlefshme për të gjithë territorin italian. Megjithatë, duke qenë Italia e ndarë në 20 Rajone, këto Rajone janë institucionet territoriale që marrin masat për mbrojtjen e shëndetit. Pra mund të ndodhë që, për disa tema specifike, rregullat të cilat vlejnë për një Rajon, mund të mos vlejnë për një Rajon tjetër. Për këtë arsye, në 2012 është nënshkruar një marrëveshje “Udhëzimet për një aplikim korrekt të normativës mbi asistencën shëndetësore për popullsinë e huaj nga ana e Rajoneve dhe Provincave Autonome Italiane”.

Nuk bëhet fjalë për një ligj të ri, por për një marrëveshje, me anë të së cilës kërkohej që të tejkalohen diferencat rajonale mbi mjekimin e popullësisë së huaj.

REGJISTRIMI I DETYRUESHËM NË SSN

Kanë të drejtë regjistrimi të detyrueshëm në SSN vetëm disa kategori personash. Arësyet kryesore që japin të drejtën e regjistrimit të detyrueshëm janë:

- puna e pavarur (pa punëdhënës), puna nën vartësi (nën vartësinë e një punëdhënësi) dhe puna stinore (sezonale);
- pritja për punësim me regjistrim pranë listave të qendrave të punësimit (institucion publik që kontrollojnë ofertat dhe kërkesat për punë);
- pritja për rregullim apo dalje nga puna e parregullt;
- bashkimi familjar dhe arësye familjare (me përjashtim për prindërit që janë në moshë mbi 65 vjeç e që kanë hyrë në Itali mbas nëntorit të viti 2008);
- kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare dhe azil politik;
- të miturit, pavarësisht nëse kanë apo jo leje qëndrimi (me disa diferencë që ndryshojnë nga një Rajon në tjetrin);
- kurimet mjekësore për gratë në periudhën e shtatëzanisë, si dhe për gjasthtë muajt që vijojnë mbas lindjes së fëmijës;
- zhvillimi i një aktiviteti punësor të rregullt, pavarësisht nga arësyeja e lëshimit të lejes së qëndrimit.

Regjistrimi i detyrueshëm bëhet falas dhe ju jep të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë qytetarët italianë, si për shërbimet përkatëse që mund të përfitoni, ashtu edhe për ticket që duhet të paguani për shërbimet shëndetësore.



Mund të shtrini regjistrimin shëndetësor edhe për familjarët në ngarkim, të cilët banojnë në mënyrë të rregullt në territorin italian.



Nëse do kem një leje qëndrimi që do të më japë të drejtën për regjistrimin e detyrueshëm, cilat dokumenta duhet të paraqes pranë ASL?

Për pjesën më të madhe të arësyeve të qëndrimit (punë, arësye familjare, etj.), dokumentat që kërkohen nga ASL për regjistrim të detyrueshëm janë:

- leja e qëndrimit apo kuitanca provizore që jepet për lëshimin apo rinovim e saj;
- dokument identiteti;
- kodi fiskal;
- dokumenti vërtetues për vendbanimin (**residenza**), apo një deklaratë dëshmuuese për adresën e shkruar në lejen e qëndrimit (**effettiva dimora**).



Kur do të bëj kërkesën e lejes së parë të qëndrimit tim në Itali, për njërën nga arësyet që do më japë të drejtën e regjistrimit të detyrueshëm, gjatë periudhës së pritjes deri në lëshimin e kësaj leje, mund të regjistrohem në SSN?

Po, mund të regjistrohesh pranë ASL, duke paraqitur sëbashku me dokumentat që kërkohen normalisht, edhe ato që dëshmojnë që është kryer kërkesa për leje qëndrimi psh, kuitanca (la ricevuta) apo autorizimi (nulla osta) që lëshohet nga Sportelli Unik i Emigracionit.



Leja e qëndrimit që do të marr, nuk më jep të drejtën e regjistrimit të detyrueshëm në SSN por, në qoftë se do të punoj në mënyrë të rregullt në Itali, mund të regjistrohem në të?

Po, të gjithë personat që kanë një kontratë të rregullt pune, kanë të drejtën e regjistrimit të detyrueshëm në SSN, dhe duhen paraqitur përveç dokumentave që kërkohen në rastet e tjera, edhe dokumentat që dëshmojnë aktivitetin e punës (kontrata e punës, partita IVA, etj.)

REGJISTRIMI VULLNETAR NË SSN

Nëse nuk do të keni të drejtën e regjistrimit të detyrueshëm, por do të qëndroni rregullisht në Itali më shumë se tre muaj, duhet të nënshkruani një sigurim shëndetësor privat për mbrojtje nga rreziqet e sëmundjeve dhe aksidenteve, (që shpesh parashikon parapagesën e plotë të shërbimit dhe më pas rikthimin e shumës), ose të kërkonti, kundrejt një pagese, regjistrimin vullnetar në SSN. Kategoritë kryesore që kanë të drejtën e regjistrimit vullnetar janë:

- studentët dhe personat që punojnë nëpër familje, pranë së cilave kryejnë vetëm disa punë shtëpiake në këmbim të fjetjes dhe ushqimit (**lavoro alla pari**) (**edhe për periudhë për më pak se tre muaj**);
- prindërit me moshë mbi 65 -vjeçare që ndodhen për bashkim familjar (e që kanë hyrë në Itali mbas 5 nëntorit të 2008);
- përgjithësisht, të gjitha kategoritë e tjera të personave që janë të përjashtuar nga regjistrimi i detyrueshëm dhe që kanë një leje qëndrimi për më shumë se tre muaj.

Personat që kryejnë atë lloj pune që në gjuhën italiane quhet **lavoro alla pari**, janë të rinjtë që pranohen pranë familjeve me të drejtën e ushqimit dhe fjetjes në këmbim të disa punëve shtëpiake.

Për të kryer regjistrimin vullnetar, duhet paguar një shumë vjetore prej € 387,34. Mbas të jeni regjistruar, do të keni të gjitha të drejtat dhe detyrimet që gëzojnë qytetarët italianë dhe ata të huaj me regjistrim të detyrueshëm.



Edhe ky lloj regjistrimi mund të shtrihet për familjarët në ngarkim.



Studentët dhe personat që jetojnë nëpër familje me të drejtën e ushqimit dhe fjetjes në këmbim të disa punëve shtëpiake (**lavoro alla pari**) duhet të paguajnë një shumë të vogël për tu regjistruar në SSN (€ 149,77 për studentët, dhe € 219,49 për të rinjtë nëpër familje me të drejtën e ushqimit dhe fjetjes në këmbim të disa punëve shtëpiake - **lavoro alla pari**).

Për të shtrirë këtë regjistrim dhe për familjarët e tyre, si studentët, ashtu edhe personat që jetojnë pranë familjeve në këmbim të ushqimit dhe fjetjes (**lavoro alla pari**), duhet të paguajnë një kontribut forfait prej (€ 387,34).

Pa marrë parasysh datën e regjistrimit dhe datën e skadimit të lejes së qëndrimit, regjistrimi vullnetar mbetet gjithmonë i vlefshëm deri në 31 dhjetor të vitit në vijim.



Cilat dokumenta duhet të paraqes pranë ASL për regjistrimin vullnetar në SSN?

Dokumentat e nevojshme janë:

- leja e qëndrimit apo kuitanca provizore që jepet për lëshimin apo rinovim e saj;
- dokument identiteti;
- kodi fiskal;
- dokumenti vërtetues për vendbanimin (**residenza**), apo një deklaratë dëshmuese për adresën e shkruar në lejen e qëndrimit (**effettiva dimora**);
- fatura e kryerjes së pagesës për kuotën e regjistrimit (për mënyrën e pagesës duhet të kërkon informacion pranë ASL-it tuaj).



Do hyj në Itali me një vizë për studime. Mund të kem të drejtën e asistencës shëndetësore?

Po, mund të kërkoh regjistrimin vullnetar në SSN, edhe nëse do të qëndrosh në Itali për më pak se tre muaj. Duhet të paraqesësh në ASL:

- leja e qëndrimit apo kuitanca provizore që jepet për lëshimin apo rinovim e saj, ose deklaratën e prezencës për qëndrim për më pak se tre muaj;
- dokument identiteti;
- kodi fiskal;
- dokumenti vërtetues për vendbanimin (**residenza**), apo një deklaratë dëshmuese për adresën reale të përkohëshme në te cilën gjendesh në periudhën e bërjes së kërkesës (**effettiva dimora**);
- fatura e kryerjes së pagesës për kuotën e regjistrimit (€ 149,77 ose € 387,34 për të shtrire regjistrimin edhe për familjaret në ngarkim).

Kujtohu që, nëse zhvillon një aktivitet të rregullt pune apo je në ngarkim të një familjari që gëzon të drejtën e regjistrimit të detyrueshëm në SSN, ke të drejtën edhe ti të regjistrohesh pa paguar asnjë shumë.



Në qoftë se kërkoj regjistrimin vullnetar në mars të këtij viti, ky është i vlefshëm deri në fund të marsit për vitin e ardhshëm?

Jo, regjistrimi vullnetar skadon gjithmonë më 31 dhjetor të vitit në vijim.

SI BËHET REGJISTRIMI



Mbasi të keni hyrë në Itali, në qoftë se keni të drejtën e regjistrimit të detyrueshëm apo vullnetar në SSN, duhet të ndiqni këtë rrugë:



1 shkoni në ASL-in e zonës tuaj dhe paraqitni dokumentat e nevojshme;



2 zgjidhni mjekun e mjekesise së përgjithshme/apo pediatrin e zgjedhur për fëmijët deri në moshën 14 vjeç nga lista e mjekëve e cila do t'ju jepet;



3 në momentin e regjistrimit, do të merrni një librezë shëndetësore, (prej letre) e cila duhet të ruhet me kujdes;



4 mbas regjistrimit, do të mbërrijë në shtëpi tesera (karta) shëndetësore: ky është një dokument i nevojshëm për të hyrë në shërbimet që offrohen nga SSN;



5 regjistrimi në SSN ka të njëjtën skadencë me datën e skadimit të lejes së qëndrimit: për ta rinovuar, duhet të paraqesësh pranë ASL dokumentat që tregojnë kërkesën për rinovimin e lejes së qëndrimit.

PËRJASHTIMI NGA DETYRIMI I PAGESËS SË TICKET



Për të bërë të mundur hyrjen në shërbimet specialiste, para se të zhvillohet vizita tek mjeku specialist, parashikohet pagesa e një ticket që kryhet pranë sporteve administrative të ambulancës apo të spitalit në të cilën bëhet vizita.

Ndërsa në disa raste, mund të fitoni të drejtën e hyrjes falas për shërbimet shëndetësore, pa paguar ticket (**esenzione - përjashtimi**). Përjashtimi nga pagesa e ticket, mundet t'ju njihet për arësye të të ardhurave në qoftë se hyni në njërin nga këto kategori:

- i mitur dhe fëmijë deri në moshën 6 vjeç, apo i moshuar në moshë mbi 65 vjeç, në qoftë se të ardhurat e grupit familjar të vitit të kaluar nuk tejkalojnë shumën € 36.151,98;
- pensionist me një pension social dhe me familjarë në ngarkim;
- i papunë apo pensionist, me moshë mbi 60 vjeç (dhe familjarët në ngarkim të tij) në qoftë se të ardhurat e përgjithëshme të familjes për vitin e kaluar nuk tejkalojnë € 8.263,31, apo € 11.362,05 duke përfshirë edhe të ardhurat bashkëshortit/es. Të ardhurat maksimale për përjashtimin nga detyrimi i pagesës së ticket (**esenzione**) rriten prej. € 516,46 për çdo fëmijë në ngarkim.

Përveç kësaj, përjashtimi nga detyrimi i pagesës së ticket (**esenzione**), mund t'ju njihet edhe në rastet kur vuani nga ndonjë sëmundje e veçantë, kronike apo të rallë, të çertifikuar nga ASL, ose në qoftë se ju është njohur gjendja e invaliditetit.

Në qoftë se mendoni që keni të gjitha kushtet për të përfutur këtë përjashtim nga detyrimi i pagesës së ticket, duhet ti drejtoheni ASL-it të cilit i përkritni.

Disa shërbime që ofrohen nga SSN janë gjithmonë falas për ata që janë të regjistruar:

- shërbimet e nivelit të parë, për të cilat nuk kërkohet as prentimi e as receta, si psh, mjeku i mjekësisë së përgjithshme, dhe pediatri i zgjedhur, konsulltorja familjare;
- shërbimet e shpejta që jepen në repartin e ndihmës së shpejtë;
- disa shërbime specialiste që kryhen para fekondimit, ose gjatë shtatëzanisë;
- shërbimet që janë të lidhura me ndërprerjen vullnetare të shtatëzanisë;
- shërbimet për diagnostikimin paraprak të disa tumoreve: grafia e gjirit, çdo dy vjet, për gratë nga moshë 45 deri 69 vjeç; PAP-Test, çdo tre vjet, për gratë nga moshë 25 deri në 65 vjeç; skopia e zorrës së trashë çdo pesë vjet, për të gjithë personat me moshë mbi 45 vjeç;
- shërbimet që kryhen për parandalime sëmundjesh e që zhvillohen në fushatat kolektive mbi parandalimet e sëmundjeve;
- shërbimet që lidhen me dhurimin e gjakut, të organeve të tjera apo të indeve;
- test për HIV;
- shërbimet shëndetësore në favor të të burgosurve dhe të internuarve.

SHËRBIMET E SSN

Mbas regjistrimit në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (të detyrueshëm apo vullnetar) keni të drejtë për shërbimet që do ju përshkruhen në vijim, falas apo duke paguar ticket.



Mjeku i Mjekësisë së Përgjithshme ose Mjeku i Familjes dhe Pediatri i Zgjedhur

Mjeku i përgjithshëm dhe pediatri i zgjedhur, të zgjedhur në mënyrë të lirë nga secili, hyrja kryesore për të gjitha shërbimet e SSN, dhe ushtrojnë falas këto shërbime:

- vizita mjekësore në ambulancë;
- recetat për ilaçe, kërkesat për vizita tek mjekët specialistë dhe analizat, nëpërmjet recetës së bardhë apo “recetës së kuqe”;
- kërkesë për shtrim në spital;
- çertifikatë justifikimi për tu rikthyer në shkollë;
- çertifikatë për ushtrimin e aktiviteteve sportive jo-konkurrese për në shkollë;
- çertifikatë (raport mjekësor) për punonjësit nën vartësi;
- vizita mjekësore shtepiake në qoftë se kushtet e shëndetit të pacientit nuk e lejojnë që të paraqitet pranë ambulancës së mjekut.

Mund të ndërroni mjekun e përgjithshëm apo pediatriin e zgjedhur në çdo moment.



Shërbimi i vazhdueshëm (i pandërprerë) asistencial (ish roja mjekësore)

Është një shërbim falas, aktiv gjatë natës (zakonisht nga ora 20.00 deri në orën 8.00), në ditët e festave (të djelat dhe festat kombëtare), në ditët para pushimeve, kur mjeku i përgjithshëm apo pediatri i zgjedhur nuk janë në shërbim, dhe për probleme shëndetësore që nuk të lejojnë pritjen e orarit të hapjes së ambulancës së mjekut të familjes. Ky shërbim arrihet nëpërmjet thirrjes telefonike. Do tju përgjigjet një mjek që mund:

- t’ju japi këshilla telefonike;
- të kryejë, nëse është e mundur, një vizitë në ambulancë apo në banesën ku jeton pacienti;
- të përcaktojë disa nga ilaçet që i nevojiten pacientit;
- të lëshojë çertifikatë mjekësore në rast nevojë dhe të propozojë edhe shtrim në spital te pacientit.

KUJDES!

Numëri telefonik i shërbimit të pandërprerë asistencial ndryshon nga një qytet në tjetrin. Për ta njohur, kërkonti informacione në ASL të zonës ku jetoni.



Konsulltorja familjare

Konsulltorja ofron falas shërbime mjekësore, psikologjike dhe sociale që ju drejtohen grave, fëmijeve, adoleshentëve, çifteve dhe familjeve. Mund ti drejtoheni konsultores për vizita gjinekologjike, për parandalimet e tumoreve, për shëndetin seksual, shtatëzaninë, asistencë mbas lindjes, ushqimi me gji, ndërprerja vullnetare e shtatëzanisë, gjendja shendetesore e kopjes për të lindur fëmijë, këshilla mbas lindjes në anonimitet të plote. Shërbimi në konsultore merret edhe me vaksinimet pediatrike e ofron mbështetje psikologjike e shoqërore familjeve, adoleshentëve, grave e fëmijëve në vështirësi.

Mund të hyni në konsultoren familjare lirisht, pa recetën e një mjeku.

Shërbimet në konsultore kryhen falas, përveç ndonjë shërbimi të veçantë për të cilin është parashikuar pagesa e ticket.

Ndërprerja vullnetare e shtatëzanisë (Interruzione Volontaria di Gravidanza)

Ligji italian parashikon mundësinë e ndërprerjes së shtatëzanisë brenda 90 ditëve. Në qoftë se vendosni të ndërprisni në mënyrë të lirë (vullnetare) shtatëzaninë, duhet të paraqiteni pranë konsultores në të cilën, mbasi të jenë vlerësuar të gjitha mundësitë e tjera, gjinekologu do t'ju dorëzojë një certifikatë të nevojshme. Më pas do lidheni me repartet e spitaleve përkatëse për kryerjen e ndërprerjes së shtatëzanisë.



Mbrojta e amësisë

Të gjitha gratë që ndodhen në Itali kanë të drejtën e mbrojtjes së amësisë. Nëse mendoni që pritni një fëmi, mund ti drejtoheni mjekut tuaj të përgjithshëm apo konsultores që ke më afër. Mund të përdorni një program specifik të asistencës gjatë shtatëzanisë, i cili garanton shoqërimin e gruas deri në muajt e parë të jetës së fëmijës, me aktivitetet që vijojnë:

1. asistencë në shtatëzani: vizita obstetrike ekografi, kontrole të analizave instrumentale, kurse të përgatitjes për lindje, konsulencë legale për gratë që punojnë;
2. asistencë gjatë lindjes: asistencë gjatë përgatitjes për të ushtruar lindjen dhe në lindje, edukim dhe mbështetje për ushqimin me gji të foshnjës, si dhe kujdesjet e para për të porsalindurin;
3. asistencë mbas lindjes: në vecanti për vizitat në periudhën e sapolindjes së fëmijës.



Vaksinat

Shëndeti i fëmijës tuaj është mjaft i rëndësishëm dhe vaksinat janë mjeti më i aftë për të parandaluar sëmundjet infektuese dhe komplikimet e tyre. Në Itali, disa vakcina janë të detyrueshme (kundër difterisë, kundër sharrëzës (tetanozi), kundër poliomielitit, kundër hepatitit B), ndërsa të tjerat janë fakultative, por të rekomandueshme. Ju këshillohet që t'ju drejtoheni pediatri për të marrë informacione dhe për tu orientuar. Vaksinat bëhen në konsultore familjare apo pranë ASL-it që i përkisni.

Në qoftë se fëmija juaj ka filluar të kryejë një cikël vaksinash në vendlindje, mund ti vazhdojë në Itali pranë konsultores familjare të zonës ku jetoni. Është e rëndësishme që të merret me vete çertifikata e vaksinave të cilat janë kryer më parë.



Ilaçet

Ilaçet që përshkruhen nga mjeku i përgjithshëm apo pediatri i zgjedhur tërhiqen në farmaci. Disa ilaçe i përkasin kategorisë së “të shpetimit të jetës” dhe janë falas, ose parashikojnë pagesën e një ticket, që përcaktohet nga secili Rajon; ndërsa lloje të tjera ilaçesh paguhen të plota; Në farmaci do të gjeni edhe të ashtëquajturat “ilaçe nga banaku” të cilat blihen, duke paguar çmimin e plotë, pa nevojën e recetes së mjekut.

Në çdo zonë ndodhet një farmaci që qëndron e hapur edhe gjatë orëve të natës, dhe në ditët e festave: çdo farmaci paraqet në vitrinë oraret mbi farmacinë e turnit që punon në zonë.

Vizitat specialistike, analizat e laboratorit dhe ato instrumentale

Për të prenotuar vizitat specialistike dhe ambulatoriale duhet të paraqiteni me “recetën e kuqe” që plotësohet nga mjeku i përgjithshëm apo pediatri i zgjedhur, si dhe me taserën (karten) shëndetësore pranë sporteve të spitalit, apo të ambulancave ku do të kryhet vizita. Në alternativë, mundet të kontaktoni me telefon zyrtar e CUP-it (Qendra e Bashkuar për Prenotimet) kompetente, për të komunikuar të dhënat e recetës së mjekut dhe të taserës (kartes) shëndetësore.

Për çdo vizitë specialistike duhet paguar një kontribut, ticket, përveç disa rasteve të veçanta ku përjashtohet pagesa (esenzione).

Kujtohu të respektosh takimin!

Në rast pengese për të kryer vizitën, është e rëndësishme që të anulohet prenotimi, të paktën 48 ore më parë nga takimi i caktuar.

CODICOME E NOME DELL'ASSISTITO (O INIZIALI OVE PRESCRITTO DALLA LEGGE)

INDIRIZZO (OVE PRESCRITTO DALLA LEGGE)

SERVIZIO SANITARIO NAZIONALE
REGIONE

CODICE FISCALE

NON ESENTE CODICE ESENAZIONE REDDITO FIRMA AUTOCERTIFICANTE

SIGLA PROVINCIA CODICE ASL

(Barre se non utilizzate)

NOTA CUF

NOTA CUF

PRIORITÀ DELLA PRESTAZIONE

NUMERO CONFEZIONI / PRESTAZIONI TIPO DI RICETTA DATA

CODICE NUMERO CODICE NUMERO CODICE NUMERO

CODICE NUMERO CODICE NUMERO CODICE NUMERO

CODICE NUMERO CODICE NUMERO CODICE NUMERO

CODICE NUMERO CODICE NUMERO CODICE NUMERO

CODICE NUMERO CODICE NUMERO CODICE NUMERO

CODICE NUMERO CODICE NUMERO CODICE NUMERO

NUMERO PROGRESSIVO

IMPORTI TICKET

GALEI SIR CHIAM ALTRO

PRESCRIZIONE

STAMPA PC

A 1 2 3 4 5 6 B 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 1



Shtrimi në spital

Mjeku i përgjithshëm, mjeku specialist, ose në situatë të rëndë shëndetësore, edhe mjeku i ndihmës së shpejtë, mund të kërkojnë shtrimin në spital të pacientit.

Shtrimi bëhet falas, kështu që nuk i detyroheni asnjë lloj kompensimi në para apo në dhurata personelit të spitalit.

Personeli shëndetësor do t'ju informojë mbi të gjitha rreziqet që mund të vijnë nga ndërhyrjet kirurgjike, nga narkoza dhe nga procedurat e tjera, ashtu edhe mbi alternativat e tjera për të njejtin trajtim.



Numëri 118

Numëri 118 është një shërbim publik falas për ndërhyrje të shpejtë shëndetësore aktive 24 orë mbi 24 mbi të gjithë territorin kombëtar. Numri telefonik 118 thirret vetëm atëherë kur paraqitet një situatë e rëndë e jashtëzakonshme, dhe kërkon një ndihmë shëndetësore të menjëherëshme. Operatorët e 118, sipas gjëndjes që paraqitet, mundet të dërgojnë një ambulancë për të transportuar pacientin drejt një strukture shëndetësore të pershtatëshme. Aktiviteti i 118 nuk zëvendëson atë që kryen mjeku i përgjithshëm apo mjeku i rojes.

Kur të thërrisni numrin 118, kujtohuni që duhet të:

- të përgjigjeni me qetësi në gjuhën italiane, pyetjeve të operatorit, dhe të qëndroni në linjë deri në momentin që t'ju kërkohet;
- Duhet dhënë numëri juaj i telefonit;
- Duhet shpjeguar ç'ka ka ndodhur dhe të shpjegohet adresa ku do të dërgohen ndihmëdhënësit.



Ndihma e Shpejtë

Në rast rreziku të jashtëzakonshëm shëndetësor (aksident, fatkeqësi në punë, situatë që vihet në rrezik jeta) mund ti drejtohesh pranë Ndhimës së Shpejtë të një spitali që ndodhet më afër teje, për të marrë sa më shpejt mjekimet e para. Në Ndhimën e Shpejtë mund të hyhet direkt e në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet shërbimit të 118.

Vizitat në Ndhimën e Shpejtë nuk bëhen në bazë të rregullit se kush vjen më parë, por në funksion të nivelit të gjëndjes së pacientit, apo të simptomave që vërehen nga personeli. Në momentin e hyrjes në Ndhimën e Shpejtë në fakt, operatorët shëndetësorë shënojnë një kod-me ngjyrë, që cakton prioritetin për të garantuar asistencën e menjëherëshme personave që janë në rrezik për jetën.

Duhet ti drejtoheni ndihmës së shpejtë **vetëm** për situata urgjente që nuk mund të trajtohen në mënyrë tjetër. Për të gjitha nevojat e tjera, të rëndësishme por jo urgjente, duhet ti drejtoheni mjekut tuaj të përgjithshëm për të kryer vizita specialiste të nevojshme nëpërmjet recetës mjekësore.

Kujtohuni që, nëse gjendeni në ndihmën e shpejtë për arsye jo urgjente, do t'ju dorëzohet një kod i bardhë. Kjo do të thotë që do të vizitoheni pas pacientëve që janë në kushte më të rënda, dhe që në të shumtën e rasteve, edhe duhet paguar një ticket.

SHËNIME

*Ky projekt është zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të
Kooperimit Ndërkombëtar italian*

Dalë nga shtypi në tetor 2014